

7.2 ASTAR PËR TRAJTIMIN E SIPËRFAQEVE PËRPARA SE TË APLIKOHEN RIFINITURA

TECNOFIX LIQUID



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
5 kg/kovë	60 cp/paletë	0.2-0.25kg/m ²	E Bardhë
20 kg/kovë	27 cp/paletë	0.2-0.25kg/m ²	--



KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Është një material i lëngshëm me bazë rrëshire akrilike, rezistent ndaj alkaleve.
- Trajtimi i sipërfaqeve me TECNOFIX LIQUID siguron punueshmëri mjaft të mirë si edhe lehtësi të dukshme në punimin e shtresave dekorative.
- Krijon një izolim dhe një lidhje shumë të mirë të sipërfaqeve të trajtuara me shtresën dekorative.
- Është astar i gatshëm për përdorim, i bardhë.
- Të gjitha karakteristikat teknike të veshjeve dekorative që do të përdoren janë të lidhura ngushtë me vetitë e astarit që do të aplikohet paraprakisht.
- TECNOFIX LIQUID redukton ndjeshëm aftësinë absorbuese të sipërfaqes ndaj ujit.
- Uniformizon shkallën e absorbueshmërisë së sipërfaqes ku do të aplikohet.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Aftësi ngjitëse
- Zvogëlon aftësinë absorbuese të suportit
- Neutralizon vlerën e pH
- Nuk ka përbërje solventi

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret si astar i sipërfaqeve që më pas do të lyhen ose do të vishen me rifinitura (BONIFIN, FINO CLASSIC etj.) ose veshje dekorative (GRAFIATO, DECORTEX etj.).

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suporti ku do të aplikohet TECNOFIX LIQUID paraprakisht duhet të jetë i thatë dhe i pastër nga pluhurat si edhe nga mbetjet e naftës, vajrave verniqeve, dyllit dhe nga materialet kundër ngjitjes. Pastrimi i vajrave verniqeve, dyllit apo materialve kundër ngjitjes realizohet mekanikisht ose në mënyrë manuale.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Produkti pasi trazohet manualisht në kovë është i gatshëm për përdorim. Mund të hollohet deri në 10% me ujë.

MËNYRA E APLIKIMIT

Produkti aplikohet me furçë ose me rrul në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Duhet të prisni të paktën 12 orë që TECNOFIX LIQUID të thahet (në varësi të temperaturës) përpara se të aplikoni produktin përfundimtar mbi suport. Temperaturat e ulëta si dhe prania e lagështisë rrisin ndjeshëm kohën e tharjes së produktit. Nuk duhet të aplikohet në temperatura me të vogla se +5°C dhe më të larta se +35°C.



TË DHËNA TEKNIKE (NË 23°C DHE 50% U.R)

Forma	Lëng
Ngjyra	E Bardhë
Ruajtja	24 muaj në paketim original në vend të thatë
Djegshmëria	I padjegshmëm
Masa volumore e përzierjes	1,2 gr/cm ³
Konsumi	0,2-0,25 Kg/cm ³
pH i përzierjes	7±1
Temperatura e aplikimit	+5°C deri në +35°C

